

lexime ballkanike

p r o z a

seria: letërsi bashkëkohore nga Ballkani
konceptuar dhe përzgjedhur nga Arian Leka

Srđan Valjarević | Komo
Titulli i origjinalit: Komo

copyright © Srđan Valjarević & Samizdat B92, 2009

copyright © i botimit shqip,
i shpërndarjes dhe i promovimit POETIKA dhe IDEART
© copyright of the translation: S. Fischer Foundation by order of TRADUKI

ISBN 978-9928-128-01-0
redaktor: Silvana Leka
realizimi grafik: Genc Goga

Botimi i kësaj vepre u mbështet nga TRADUKI, një rrjet ndërkombëtar, të cilit i përkasin Ministria Federale për Çështje europiane e ndërkombëtare e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale Gjermane, Fondacioni kulturor zviceran Pro Helvetia, KulturKontakt Austria, Instituti Goethe, Fondacioni S. Fischer, Agjencia sllovene e Librit JAK dhe Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë.

traduki

traduki

Shënim: Për përkthimin është përdorur botimi
Samizdat B92, 2009
ISBN 978-86-7963-284-5

K O M O

Përktheu nga origjinali Ben Andoni



botimet poeteka



Ishte e marta e një fillimnëntori, ditë me diell dhe e nxehtë, dhe unë thjesht nuk e dija se për ç'arsye, apo dhe as si ndodhi, asgjë nuk dija atëherë, por ja që kështu ndodhi. U gjenda në avionin që fluturonte drejt Zyrihut, ulur në ndenjësen e tij, pikërisht në avionin e kompanisë zvicerane. Nga Zyrihu duhej të këmbëja aeroplanin për në Milano. Vetëm këtë dija. Në Milano duhej të më priste shoferi, i cili do të më çonte në vendin e quajtur Bellaxhio, në liqenin e Komos. Kjo ishte gjithë ajo që dija.

Kisha pasaportën me vizë italiane, të cilën e mora pa problem në Beograd, kisha ca para me vete dhe në xhep kisha edhe ftesën nga ky fondacioni i huaj, deri atëherë për ta unë isha si gjithnjë, një shkrimtar i ri nga Serbia, vend i cili që në gjendje dëshpëruese dhe ku jetohej keq. Dhe nuk e di sesi, madje kurrë nuk do e merrja vesh, por e pranova këtë bursë për të kaluar një muaj në liqenin e Komos dhe atje të punoja e shkruaja në qetësi. Kjo ishte ideja e tyre dhe jo imja. Deri atëherë s'kisha pasur as edhe interesin më të vogël në ndonjë punë apo shkrim në qetësi. Dhe, as edhe një punë deri më atëherë nuk më kishte kënaqur në përgjithësi. Nga botimet e librave sapo kisha hequr dorë. Në Serbi ishte vërtetë keq, ishte tmerr, por për mua dhe jo aq, duhet të mbijetoja, kisha bëra nga pak disa punë të ndryshme dhe jetoja dhe ia dilja edhe me këto. Shkruaja tregime të shkurtra për një gazetë të përditshme bashkëkohore, paguaja qiranë dhe haja e pija, kryesisht pija, përgjithësisht mbijetoja, po më pak se prej gjithçkaje, prej shkrimeve. Shkruaja dhe ndonjë gjë për vete,

në fletore të vogla të thjeshta, por pa ndonjë qëllim serioz, as me ndonjë lloj ambicie. Kur nga Komo mbërriti ftesa e papritur e Fondacionit Rockefeller, e plotësova në rregull dhe, në pyetësozin e saj se çfarë do të bëja atje, shënova se do të shkruaja një roman. Pija birrë ndërsa shkrova skicën e shkurtër për këtë roman, krejt e kam sajuar, ndërsa miku im, Vlado e përktheu të gjithën në anglisht. Ishte ai që e mbajti disa kohë në vendin tim korrespondencën me ta, dhe u postoi pas këtë formular po në emrin tim. I bëja shoqëri, pija birra dhe mësoja anglishten nga ai. Nuk na u desh ta prisnim për shumë kohë përgjigjen, sepse ftesa zyrtare mbërriti dhe unë isha i përgatitur. Njerëzit atëkohë e linin vendin pa ndërprerë. Vazhdimisht dhe gjithnjë njerëzit e linin këtë vend. Unë po shkoja vetëm për një muaj dhe miku im Vlado ishte njeriu që i rregulloi të gjitha, ndaj ai e meritonte të shkonte.

Në aeroport bëra *check*-imin e çantës së udhëtimit dhe s'isha aq i sigurt se çfarë kisha paketuar në të. Isha i pirë kur e paketova. Numërova me vete vetëm gjërat që dija se i kisha harruar: një libër, adresa e dikujt, diçka nga pajisjet e higjienës, këto patjetër, një xhaketë dhe një pulovër. Por e dija se sapo të isha vendosur atje, do të kujtohesha se kisha harruar ende gjëra. Megjithatë, për mua ishte njësoj. Isha mahmur, ndërsa po i përfytyroja të gjitha, kur dëgjova në avion bisedën e dy vajzave në ndenjësën para meje. Ato të dyja udhëtonin në Zvicër dhe nga bashkëbisedimi i tyre kuptova se njëra nga ato ishte këngëtare dhe atje këndonte nëpër kafenetë ku mbledheshin "njerëzit tanë". Kjo këngëtare tha: "E gjithë çfarë më duhet janë thjesht dyzetë mijë franga zvicerane dhe atëherë i kam të gjitha dhe shtëpi, dhe garazh, makinë, pishinën dhe gjithë çfarë dua..."

Isha tmerrësisht përgjumshëm dhe mbylla sytë duke menduar se megjithatë ishte mirë që në jetë ndodhnin të tilla gjëra, të papritura, sepse po të mos ishin ato, do të isha çmendur. Sigurisht që do çmendesha. Një natë më parë e kisha kaluar në kafe me miqtë në Bulevard, tek Tregu. Pimë si zakonisht, por këtë herë pimë shumë më tepër, e kishim

arsyen, po ikja për udhë dhe ata po më përshëndesnin: atëkohë rrallë udhëtonte ndonjë nga ne, nuk ishim nga ata të cilët iknim dhe as nga ata të cilët kishin para për udhëtime, dhe ndaj pimë deri natën e vonët. Njëri nga miqtë e mi derdhi një kovë me ujë pas meje kur u ndamë. Kjo ishte për udhë e mbarë. M'u kujtua kjo në avion dhe pikërisht atëherë, teksa po i sillja nëpër mend të gjitha nga nata e mëparshme, këngëtarja në ndenjësën para meje tha: "E qifsha në gojë, nuk do ndahet kurrë nga e shoqja..." E kishte fjalën për një burrë për të cilin i fliste shoqes së udhëtimit.

Stjuardesa solli ushqimin në kutinë plastike, i kërkova asaj birrë ndërsa ajo ma ktheu se s'kishte birrë, vetëm lëng, ujë me shishe plastike, çaj dhe kafe. I thashë se më pëlqente shumë birra dhe që s'ishin problem paratë, do e paguaja dhe se më pihej birra, isha tmerrësisht mahmur dhe doja shumë ta kisha një birrë. Folëm në anglisht. Më përsëriti që s'kishin birra. Dhe më tha se kishin ca tableta, nëse kisha frikë fluturimin. Isha i përgjumur dhe frikësohesha nga çdo gjë, por doja vetëm birrën, këtë i thashë asaj dhe nuk më duhej asnjë tabletë dhe se një birrë mund të më ndihte, ndërsa ajo më dëgjonte dhe shikonte e habitur. Më tha diçka në gjermanisht, iku dhe u kthye me një kolegun e saj, një burrë të gjatë me mustaqe, i cili duke qeshur në anglisht më pyeti me mirësjellje për çfarë ishte problemi.

"Asgjë nuk kam as edhe një problem, vetëm se do doja të pija një birrë", i thashë.

"Kemi verë të bardhë dhe shisheza me uiski dhe vodka, nëse do tamam alkool, por për këto duhet të paguash", më tha.

"Jo, s'janë problem paratë, dhe s'është problemi të alkooli, vetëm jam si mahmur dhe vetëm birra më shkon, kjo është e gjitha", i thashë sinqerisht.

Qeshi. I tha diçka në gjermanisht stjuardesës, e cila qëndronte pranë tij dhe atëherë dhe ajo qeshi.

"E di si gjendje kur vjen nga e pira. Dhe mua më pëlqen shumë birra kur jam si mahmur. Do mund të gjej të paktën ndonjë shishe *Heineken*", tha ai.

“Nëse do të mundeshe tre shishe, do ishte mrekulli”.

“Nuk do më shumë?” më pyeti qetë.

“Jo, sigurisht, tre shishe do të ishin të mjaftueshme”, i thashë.

“Do i kesh të gjitha në rregull. Do t’i gjejmë ne...Dhe, fluturim të mbarë”, më tha dhe buzëqeshi.

“Besoj, do kënaqem, dhe faleminderit”, iu përgjigja.

Mora tre shishe birre, i pagova dhe atëherë çdo gjë ishte vërtetë në rregull, por dhe stjuardesa filloi të buzëqeshë, një birrë e piva menjëherë, ndërsa hëngra edhe ushqimin nga qesja plastike e pas kësaj fillova të hurb birrën e dytë. U qetësova. Avioni po fluturonte. Shikoja retë, ishte kthjellët. Ishte një fluturim i qetë. Piva dhe shishen e tretë. Ndërkohë, avioni u ul.

Në aeroportin e Zyrihut nuk kisha shumë kohë, vetëm rreth njëzetë minuta që i kalova në Sallën e Pritjes dhe mendoj se isha i vetmi pa telefon celular me vete. Ishte kjo një botë biznesi, apo mua më dukej të paktën kështu, apo thjesht njerëzit vrisnin kohën duke telefonuar në këtë lloj mënyre. Ishte mërzia dhe kështu që tre herë shkova në banjë: njëherë bëra nevojat, dy herë ika thjesht të pija ujë dhe të laja duart. Herën e tretë dhe të fundit kur dola nga banja, disa tipa biznesmenësh më kanë këqyrur. Askush nuk e pëlqen kur një dikush e këqyr dhe ca më shumë në aeroport, arsyeja është e kuptueshme, terrorizëm, bombë kjo më shkonte në mendje apo që njerëzit thjesht e kishin frikë fluturimin. Kurse unë vetëm nga mërzia ika në banjë, vetëm tre herë dhe kjo s’ishte aq shumë. Shpejt, pas kësaj u futa në avion, aeroplani fluturoi, piva një ujë mineral kur avioni sapo zbriti në aeroportin e Malpensës në rrethinat e Milanos. Ishte një fluturim vërtetë shumë i shkurtër. Mora çantën, kalova pa problem kontrollin e pasaportës dhe doganën, u tregova ftesën time nga fondacioni dhe të gjitha ishin në rregull, ishte fondacioni Rockefeller, kuptohet që çdo gjë ishte në rregull, kur pashë para një njeri duke mbajtur një tabelë ku shkruhej: Qendra Belaxho. Dhe poshtë kësaj me shkronja të

mëdha emri dhe mbiemri im. I tunda dorën, ai u afrua dhe u përkul të më merrte çantën.

“Jo, në rregull, mundem ta mbaj”, i thashë.

“Jo, jo, kjo është puna ime”, më tha.

“Po, në rregull, s’është çantë e rëndë, s’është ndonjë problem”.

“Jo, të lutem, kjo është puna ime”, më tha sinjerisht.

Ia lashë. E kapi çantën dhe e vendosi mbi shpatulla. Më tregoi se nga do niseshim. Ishte hera e parë në jetën time, ndërsa ecja pas këtij njeriu që mbante gjërat e mia, që ndjehesha vërtetë budalla, tamam si disa zotërinj. Që prapë do të thoshte jashtëzakonisht budalla. Por s’ishte dhe aq keq, ishte sikur të dy diçka luanim si unë dhe ai.

Duke luftuar për çantën. Por kjo ishte në rregull. Mbërritëm në një autobus udhëtimi, ai më hapi derën dhe u futa brenda. Ndenjësja ishte njësoj si ajo e avionit. E rehatshme. Ecëm përreth një orë e gjysmë, ishte plotësisht errësirë me një mjegull të trashë e me një shi të hollë dhe përveç automobilave të tjerë dhe dritave të fenerëve, nuk shihej gati asgjë, disa herë dremita dhe dikur kapa shikimin e shoferit në pasqyrën e makinës. Mendoj se sjellja ime për të ishte e pazakontë, kështu m’u duk të paktën, derisa më ra koka dhe më kapi dremitja apo ndoshta ai priste ndonjë tjetër, më ndryshe, më të vjetër, por nuk kemi folur asgjë gjatë gjithë kohës dhe vetëm kur arritëm, ai tha:

“Ja, kjo është Belaxho”.

“Vend i këndshëm dhe u dukërka bukur”, i thashë.

Në të vërtetë kjo s’kishte ndonjë rëndësi, por thjesht duhej që ta thosha dhe kjo ishte krejt pa kuptim, sepse asgjë nuk shihej. Dhe biseda jonë ishte pa kuptim. Ishte krejt errësirë. Një kodër e madhe e errët, çatitë e shtëpive, tutje uji i errët të liqenit të Komos, dhe vetëm sa shikoheshin dritëzat e turbullta të rrugës. Ishte natë dhe s’kishte njerëz. Arritëm në këmbët e kësaj kodre të madhe, kaluam përmes një porte hekuri jashtëzakonisht të madhe, që u mbyll menjëherë pas nesh dhe mbërritëm në një shtëpi të madhe, ku shkruhej “Vila

Maraneze". Këtu më priste zonja Bela, ashtu si m'u paraqit, një grua e vockël e vjetër me flokë të shkurtër, e zonja e vilës, dhe e zonja e gjithë kësaj kodre. U prezantuam. Më tregoi dhomën e punës në katin përdhes dhe pastaj ikëm në katin e apartamentit tim, i cili më ishte caktuar për një muaj. Pastaj më thirri për ngrënien e darkës në vilën kryesore "Vilën Serbeloni". Më shpjegoi se si mund t'i bija më shkurt drejt vendit të ngrënies dhe shkoi. Të gjitha shkuan shpejt. U rregullova, lashë çantën, dhoma ishte e gjitha e bardhë dhe të gjitha ishin të bardha aty: krevati, WC, muret, kolltukët. Dukej bukur. Kundërmonte erën e lavanderisë. Apo të çajit të mendrës. Nuk isha krejt i sigurt. U ndërrova dhe shkova deri te ajo vila kryesore Serbeloni. Atje më shërbyen, mora dhe hëngra biftek, oriz dhe karota, piva disa gota me verë të kuqe dhe pas po kaq gotave me ujë mineral kisha kamerierin tim, që më tha se nuk kisha pse nxitoja kaq, atëherë i kërkova sërish verë, kurse ai më shtiu dhe pastaj më sqaroi se në cilën kohë shërbeheshin vaktet, e shtoi se pas pak ditësh do t'i mësoja dhe vetë si duhet dhe s'do më duhej më ndihma e askujt. Jemi përshëndetur dhe u ktheva në apartamentin tim.

Më vinte mirë që nuk harrova radion e vogël me transistor, shkova në banjë, gjeta një stacion me muzikë të përshtatshme, lëshova ujin e ngrohtë dhe u futa në vaskë. U shtrijqa. Vaska ishte më e gjatë se unë, munda të zhytesha dhe më, të shtrija këmbët dhe të kisha të gjithë trupin nën ujin e ngrohtë. Po mendoja se unë që shpesh s'e kisha ditur se çfarë të bëja me veten në jetë, ja, tani arrita të isha i aftë të vlerësoja sesi më dukej kjo "Vila Maraneze" në liqenin e Komos.

Më pas u plandosa në krevatin e madh sa për dy veta, ktheva stacionin e radios dhe në valët e gjata gjeta një stacion radioje kroat. Po jepte lajmin se "Partizani" i Beogradit kishte fituar kundër "Zagrebit" të Kroacisë në basketboll, por mua veçanërisht kjo s'më thoshte gjë, përveç asaj që më në fund kuptova çdo fjalë të shqiptuar. Ishte gjuha ime. Madje edhe pas gjithë luftërave, megjithatë arrija të kuptoja çdo fjalë dhe kjo s'kishte ndryshuar...Dhe pastaj dëgjova ca drejtues

emisionesh dhe një muzikë të qetë nga Kroacia dhe kështu më zuri gjumi.

Kjo ishte një nga gjërat më të çuditshme me këto lloj radiosh të vogla që ju e vendosni në gji apo afër veshit dhe ke përshtypjen që diku pëshpëritet diçka për ju, pavarësisht gjuhës, njësoj është dhe kështu edhe të zinte gjumi.

Fjeta gjatë deri në orën dhjetë. Isha i lodhur nga kjo ditë mahmur prej udhëtimit dhe ndaj fjeta mjaftueshëm. Të gjitha ngjanë kaq shpejt dhe së fundi isha krejt esëll dhe drejt e përmes një diçkaje të re. Tejet ndryshe. E gjitha kundërmonte madje ndryshe. Dhe ishte kaq e pastër. Dëgjova sesi dikush hapi derën. Hyri brenda gruaja e shërbimit dhe pyeti nëse ishte e lirë. Shpejt u ktheva anash dhe sërish mbylla sytë dhe bëra sikur po flija. Ajo doli fare e qetë. Mëngjesi shërbej deri në orën nëntë dhe vetëm tani arrita në përfundim se nuk do mundesha të haja mëngjes, për të gjithë muajin tim të qëndrimit sepse këtu i kisha të gjitha kushtet të mos çohesha herët. Shkova poshtë në dhomën e punës, bëra një kafe dhe u ula në tryezë. Hapa dritaren dhe që andej pashë në drejtim të liqenit të madh, e tashmë të kaltër dhe në parkun e gjelbër të stërmadh të "Vilës Serbeloni" dhe sfondin e majave të bardha të maleve gri, ndërprerë nga retë e errëta të dendura. Çdo gjë kishte një ngjyrë të plotë. Ajri ishte i lagësht, ishte qetë dhe një vend i paqme. Unë ndeza radion e vogël, gjeta një stacion italian me muzikë dhe piva kafe.

Dhe atëherë, papritur e gjitha mu bë jo e zakonshme por e këndshme: qëndroja në studio ashtu si thërritej dhoma e punës, në katin përdhes të vilës, kisha kompjuterin, printerin, një bibliotekë të vogël, kryesisht me enciklopedi, por që kishte dhe disa libra të tjerë, kisha një aparat për kafe, një frigorifer me lëngje dhe ujë mineral, një pjatë plot me fruta të freskëta. Hapa kompjuterin, ngadalë solla ndër mend sesi punonte ky aparat. Pak vjet më parë isha praktikuar të bëja

deri një letër me të, por megjithatë mbeta në makinën e shkrimit, dhe më shumë shkruaja me dorë, me laps kimik apo me stilograf "Parker".

Çështje shprehie, por edhe për çështje parash, me shkrimin asnjëherë nuk kam fituar as për të pasur kompjuter dhe për gjërat e tjera, që i kisha të rëndësishme në jetë. Gjithë ato që kam fituar me shkrimin, ndonjë shumë si serioze, e shfrytëzova nja dy herë, njëherë për ishujt grekë dhe endjet nëpër Athinë në Pire dhe herën e dytë për një shok të mirë me të cilin bëja shaka në Andaluzi. Ato ishin më të rëndësishme se kompjuteri në atë kohë. Dhe kjo ishte e gjitha nga shkrimi. Për mua ishte më mirë të shkruaja rrëfenjat me stilograf, me laps apo t'i shtypja në makinë shkrimi për gazetat dhe të fitoja me to para për banesë. Dhe nëse mbetej diçka edhe të udhëtoja diku. Kjo do ishte më e mira për mua. Por tani më dukej qesharake dhe nga pak dhe pa logjikë. Kisha borxh qiranë edhe për një muaj për garsonierën në Beograd, të cilës i rridhte çatia dhe mbase tani në Beograd vërtetë po binte shi, këtë mendova atëherë, dhe ndoshta ishte përmbytur kjo banesë e vogël sepse s'kishte askënd të vendoste tenxheren dhe kovat në vendin nga ku rridhte shiu, por pas të gjithave, kjo për mua s'kishte edhe aq rëndësi. Ajo s'ishte banesa ime dhe s'kishte brenda asgjë të vlefshme. Kisha akoma edhe disa borxhe, jo të mëdha por megjithatë mbeteshin borxhe. Dhe atëherë kur po mendoja për to, e shikoja nga vila përmes dritares, pashë sesi dy gjela po fluturonin në park, mbi kodrat e vogla me plot ullinj dhe selvi të larta dhe erdhën menjëherë këtu, poshtë dritares sime, ku ndodhej një dru portokalli. Kurora ishte e gjelbër dhe ishte plot fruta, që po kuqëlonin. Isha kaq larg të gjitha gjërave.

Kjo ishte dita që dola për herë të parë për drekë në "Vilën Serbeloni". U ula në tryezë me zotin Menudi Uinter, profesorin e kompozicionit në Departamentin e muzikës në universitetin Brendis në Amerikë dhe zonjën Jarkin Kirskilova, profesororeshën e letërsisë nga Kirgistani dhe profesorin e asociuar në Universitetin e Romës, e cila ashtu

si më tha po punonte në një studim të krahasuar për romanet e shekullit XX. I rruar, veshja xhaketën e vetme që kisha, u kreuha, dhe u ula në një tryezë të madhe të rrumbullakët dhe kur u thashë se jam nga Serbia, profesoresha nga Kirgistani më tha se që kur kishte ardhur në Belaxho, çdo mëngjes ndjehej e habitur, e gjithmonë e hutuar dhe mendimi i parë që i shkonte ndërmend ishte se çfarë donte në të vërtetë këtu. Atëherë unë i thashë asaj se e njëjta gjë më ndodhi edhe mua në mëngjes dhe sigurisht kjo do më priste dhe në muajin e ardhshëm. Profesor Menudi, padyshim një njeri llafazan, tha se ky për çfarëdo arsye ishte një vend i mrekullueshëm për punë dhe pushim. Për mua ideja se në këtë vend mund të bëjë ndonjë lloj pune, ishte e pakuptimtë. Atëherë ai na tregoi disa anekdota, por mua asgjë nuk m'u duk për të qeshur ose nuk i kuptova, mbase ngaqë ai i tregonte shumë më shpejt për njohuritë e mija të anglishtes. Piva një gotë të një vere të bardhë dhe dola jashtë të ndizja një cigare. Brenda nuk ishte e lejuar. Për çdo rast, ky ishte një justifikim për t'iu arratisur shoqërisë në sallon dhe pirjes së kafes dhe çajit.

Edhe pse ishte lagësht dhe ftohtë, shëtita në shtigjet e ngushta përmes pyllit, deri në majë ku gjendej një kullë, mbetur nga ndonjë fortifikatë e vjetër, lart fshatit Belaxho. Natyrisht, në një çast dhe humba, kuptohet, apo më saktë u ktheva në qerthull, e dy herë jam kthyer në të njëjtin vend, tek një çezmë. E pasi humbja e orientimit është shenjë lodhjeje u ktheva në banesën time, u ula në studio, bëra një çaj dhe gjeta *Internacional Herald Tribune* në tryezë. E mora dhe shtypin. Klubi francez "Lion" kishte mundur "Crvena Zvezda" 3:2 në futboll dhe në Kosovë sërish ishin vrarë civilë. I lashë gazetën dhe u ula në tryezë. Nuk më lexoheshin këto gazeta. Më duhej ndoshta diçka tjetër të punoja, por kjo për mua ishte e pamundur në këtë vend. Rashë në gjumë. Isha ende shumë i lodhur nga udha. Për shumë kohë s'kisha qenë në prehje të tillë dhe në kaq vend të qetë. Dhe fjeta gjithë kohën deri në mbrëmje.

Në shtatë e gjysmë ika për darkë. Duhej vendosur kravata siç më thanë. U kërkova ndjesë, u thashë se nuk mbaja kravatë dhe se kisha vetëm një, të verdhë me pika të kuqe, shumë ekscentrike që ma solli miku im Çaki si dhuratë, tamam për këto raste, kur jemi ndarë atë natën e pijes. Nuk e vendosa, ishte tejet e nderur për shijen time, por për mirësjellje i mbylla kopsat e këmishës deri lart. Piva një dopio bourbon para mbrëmjes dhe pastaj një tjetër dhe kur desha të marr dhe një tjetër, kamerieri më rrëmbeu gotën dhe me mirësjellje më tha se tani ishte koha të ulesha për darkën e përbashkët në sallën e madhe të darkimit, nga ku pastaj filloi të na shërbejë ushqimin.

I thashë: "Në rregull" në anglisht, por në vetvete thellë u frikësova se ndoshta këtu do kisha probleme me pijen. Me këtë kamerier u njoha që mbrëmjen e parë, sa kam mbërritur dhe me ato sa më tha, ai e kishte të shoqen hungareze dhe se njëherë kishte qenë në Beograd dhe i kish pëlqyer shumë. Duhet të ishte i sjellshëm. Në kohën e mbrëmjes piva me fund disa gota vere e kamerieri vetëm sa ma mbushte me një verë të mrekullueshme të kuqe toskanase dhe më buzëqeshte. Më pas i sqarova se vera ishte e mirë dhe pos gjithë të tjerave, ishte një nga gjërat që s'kishte Beogradi, dhe atëherë i dhashë të dinte se kjo ishte edhe një nga dobësitë e mia dhe se nuk mund të ma kursente kur ia kërkoja. Kamerieri vetëm tundte kokën, e kuptoi dhe qeshi. Në të njëjtën mbrëmje, një tip nga Gana, kuptohet i zi, sqaroi sesi po hulumtonte malarien dhe se për cilën arsye shtrirja e sëmundjes ishte e pamundur të ndalohej në disa nga vendet afrikane. Nuk i kuptova të gjitha, por as nuk jam kujdesur ta dëgjoj. Malaria. Unë për këtë nuk mund të mësoja në të vërtetë asgjë, mendova në atë çast, kur një njeri në anën tjetër të tryezës, m'i kishte ngulur sytë. Shikonte sesi pija njëra pas tjetrës gotat me verë të kuqe. Ky ishte një profesor i vjetër nga Toronto, me të cilin u njoha para mbrëmjes dhe e harrova menjëherë sesi quhej. Por u kujtova se po bënte studime për Spanjën nga shekulli i XVI në XVIII. Kështu më tha. Një njeri fin, ndoshta kurrë s'kishte

parë më parë një njeri që të pinte më shumë sesa një gotë verë. Sapo hëngra dhe piva doja të dilja jashtë, të ndizja një cigare. Kuptova se isha i vetmi ndër njëzetë miqtë në vilë që e pija cigaren. Kurrë ndonjëherë nuk kisha qenë kaq ndryshe nga të tjerët, edhe pse e gjitha që bëja më dukej krejt normale, të tymosja cigare, të zbrazja gota me verë, pa kravatë, por megjithatë me xhaketë, në të vërtetë normale. Isha i vetmi që ndizja cigare. Kështu u largova. Një zotëri i vjetër u shfaq në bahçe dhe më pyeti se nuk kisha ftohtë që rrija jashtë dhe kur i thashë se dola thjesht të pi cigare ai qeshi me zë. Që kur fillova të tymos në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare dhe deri tani s'isha orvatur kurrë ta ndaloja, e për mua s'kishe asgjë për të qeshur për të. Për të kuptohet që kishte, tamam kështu, që dikush të rrinte në të ftohtë thjesht për të pirë një cigare. Dhe kjo ishte në rregull, e kuptova atë. Për dikë mund të ishte pa logjikë, por për mua kjo kishte arsye. Dhe kjo kishte tamam shumë arsye, sidomos në të tilla vende, si kjo në bahçen e Rockefeller-it. Pastaj u ktheva brenda dhe hyra në sallonin ku qëndronin të gjithë dhe dërdëllisnin. Në qoshe pashë tryezën e vogël lëvizëse me shishet me pije. Mora shishen e një lloj konjaku dhe e shtiva në gotë. Dhe atëherë mora edhe shishen dhe me gotën me vete dhe e boshatisa të gjithën ndërsa shquaja fotografitë, orenditë dhe njerëzit dhe madje edhe u fjalosa nga pak me disa prej atyre që ishin në sallon.

Më pas, pak para gjumit, ktheva butonin e radios dhe kapa *Zërin e Amerikës* në gjuhën serbe. Dëgjova një lajm për të përditshmen *Danas*, krijuar bash në kohën e ligjit të ri fashist të medias, gazetën e cila shtypej në Malin e Zi, e në të cilën kisha botuar tregimet dhe tekstet, se ishte konfiskuar në kufi me Serbinë. Pastaj ky stacion u bllokua dhe nuk dëgjova më se çfarë kishte ndodhur më shumë në lidhje me të. Më duhej të kërkoja një punë tjetër kur të kthehesha në Beograd, dhe ku ta dish ndoshta mund të kërkoja punë edhe këtu mendova, mund të mblidhja gjethe në park, kjo do ishte vërtetë punë shumë e mirë. Të bëhesha kopshtar. Bukur. Pastaj dëgjova *Radio Monte Karlon*, këtu ishte muzika më e bukur dhe kështu

sërish rashë për të fjetur. Për herë të tretë brenda kaq pak kohësh. Më flihej. Më vuri në gjumë kjo qetësi rreth liqenit dhe në *Vilën Mareneze*, kjo qetësi dhe ky ndryshim i madh papritmas i mjedisit, një ndryshim vërtet i madh. Ishte e gjitha kaq shumë ndryshe saqë mua më tronditi.

Më zgjoi dielli. Shkëlqente shumë, depërtoi në dhomën e bardhë përmes dritares së madhe dhe mu derdh direkt e në fytyrë. U ngrita dhe hapa gjerësisht kanatat dhe mendova se asnjëherë më parë s'isha zgjuar me një të tillë pamje kaq të bukur si tani nga kjo panoramë përmes dritares së dhomës, në këtë mëngjes të mrekullueshëm. Jo, asnjëherë sigurisht. Ishte nxehtë, ajri ishte i pastër, i freskët por ishte nxehtë. Në qiell s'kishte as edhe një re të vetme. Pashë liqenin e kaltër dhe majat e errëta të maleve përreth. Bora zbardhonte në këto maja. Këto ishin Alpet. Ngjyra e tyre ishte e vërtetë, e fortë, i kënaqin sytë, kaq shumë gjelbërim, përreth liqenit me blunë e thellë. Dhe nxitova për jashtë.

U drejtova në drejtim të fshatit, por menjëherë para vilës në kopsht, takova atë të ziun nga Gana, apo një nga ata, deri tani nuk i dalloja dot, më zgjati aparatit dhe mu lut që ta fotografoja me *Vilën Serbeloni* në sfond. Më tregoi sesi përdorej aparati dhe atëherë u vendos me duart në ije dhe shikimin kureshtar fiksuar në largësi, priti që ta shkrep dhe nuk lëvizi dhe kur e shkrepja, ndryshoi pozën, tendosi duart dhe i zgjati ato drejt diellit duke parë i qeshur nga objektivi. Atëherë kuptova që ai e bënte këtë me qëllim dhe kjo sigurisht diçka do të thoshte, ndonjë zakon apo ritual me këto dy poza njëra pas tjetrës. E fotografova atë dy herë, u përhëndetëm dhe atëherë u ula poshtë në fshat, por më parë hapa portën përmes të cilës hyje në këtë kodër, në të cilin ishte shkruar "pronë private" në anglisht dhe e përplasa pas vetes, sërish i ndërë budalla, si disa lloje zotërinjsh. Tamam atëherë kaluan dy

vajza, i kam ndjekur për pak nga pas dhe atëherë u përkula të lidhja lidhësen e këpucëve. Dhe këqyra të ndenjurat e tyre. Ishin vërtetë të këndshme këto vajza.

Belaxho ishte e bukur, një vend i vogël poshtë Alpeve, realizuar në stilin mesdhetar me rrugicat e ngushta, që mund t'i vizitonte shpejt për gjysmë ore. Përgjatë bregut deri tek moli kishte shumë palma dhe ishte e çuditshme sesi mund të qëndroje poshtë gjetheve të palmës dhe të shikojë drejt Alpeve me borë në largësi. Pashë dyqane të shtrenjta, njerëz të veshur bukur, makina luksoze dhe kuptova se nuk ishte fshat i zakonshëm por një vend ku jetonin njerëz të pasur. Nuk është keq të jesh i pasur, mendova, ke jaht, shtëpi në këtë liqen, mund të blije të gjithë këto pallto, këmisha, xhaketë, këpucë dhe pulovra nga disa qindra apo deri në të mijëra dollarë. Por s'ishte keq dhe kur s'ishe i pasur dhe kur s'kishe asgjë nga këto sepse të gjitha nuk kanë ndonjë lidhje aq të madhe me vetë jetën. Por ndalova para reklamës së një dyqani vere, këtu ndodhej tamam ajo që vërtetë më kënaqte dhe që lidhej me jetën time, verën: vera italiane nga rajone të ndryshme, por edhe ajo franceze, kiliane, kaliforniane, gjermane, australiane, portugeze... Kjo më interesonte shumë. Doja t'i provoja të gjitha këto lloje verërash. Ishin të shtrenjta. Flegrat e hundës mu zgjeruan shumë, por s'hyra brenda doja vetëm të kujtoja se ku ndodhej ky dyqan, e kur ndonjëherë të mërzhitesha sipër në vilë, po mendoja tamam këtë atëherë, të vija në këtë dyqan dhe të merrja ndonjë vere të mirë të kuqe me karton, të ngjitesha në kodër të kënaqesha me të dhe të dehësja. Dhe atëherë gjithçka mu duk e lehtë dhe tashmë mund të kthehesha në vilë sepse mbërriti koha e drekës.

Gjatë kohës së drekës, kuptova se duhet të nxirrja në pah një tjetër gjë: hëngra pak më shpejt se gjithë të ftuarit. Dhe i vetmi që gromësiva, por pa më parë dhe dëgjuar njeri. Kjo më kishte mbetur nga fëmijëria e hershme- zakoni që të mbushja gojën dhe stomakun, thjesht ta bëja dhe këtë punë, pa ndonjë gëzim të tepruar, dhe të lirohësja. Dy vezë sy ishin mjaft për mua. Ajo profesoresha e letërsisë nga Kirgistani,

zonja Kirskilova, pesëdhjetë vjeçare më pyeti nëse romani që po shkruaja do ishte politik apo psikologjik.

"Cili roman", e pyeta.

"Po lexova se e kishe marrë bursën të shkruanit një roman këtu", tha ajo.

"Ah po, kështu kam shkruar në formular, saktësisht. Po do ta shkruaj, do e shkruaj", i thashë.

"Por?"

"Çfarë?"

"Po temë politike apo psikologjike?-më pyeti sërish.

"S'ia kam idenë. Psikologjik ka të ngjarë", i thashë.

Filloi të më mblidhej diçka në gjoks, kjo më ndodhte gjithnjë sak në këto situata, e në këto lloj bisedash, kudo dhe gjithkund më kapte një ngërç, më bëhej komb në gjoks dhe këpucët më bëheshin bezdi dhe më vrisnin, dhe këmisha më ngushtonte, sidomos rreth qafës. Shkopsita kopsat e këmishës. Atëherë profesoresha më pyeti papritur nëse besoja në Zot ndërsa unë ia ktheva se nuk e dija. O, njeri, çfarë mu desh që u ula pranë kësaj gruaje, vetëm për këtë mendova. Atëherë ishte ajo që më tha se nuk e kishte besuar asnjëherë zotin, por me kohë ishte bërë fetare. I thashë se kjo ishte e kënaqshme dhe e pyeta nëse kishte lidhje kjo me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik. U duka pak budalla dhe kuptohet i pacipë. Nuk ishte me ndonjë qëllim të keq. Ajo më tha që sigurisht se s'kishte lidhje. Atëherë ashtu si mundesha bëra shaka dhe shtova se dikur kisha qenë fetar, por që s'isha më. Atëherë ishte ajo që e vlerësoi këtë e para si problem serioz, paçka se isha njëzetë vjet më i ri se ajo, por pastaj e kuptoi si papjekurinë time dhe qeshi dhe unë rashë dakord me të, që të mbetesh në këtë papjekuri, por vetëm të më linte në paqe. Këtë kisha dashur vërtetë. Ishte budallallëk dhe pacipësi dhe ishte një pozicion ideal për mua, që të tillë njerëz të mos më bezdisnin. Dhe e hëngra krejt lakrorin e mrekullueshëm me spinaq dhe djathë dhe sërish, natyrisht, hurba verën e mrekullueshme të kuqe. Por zonja nuk hoqi dorë.

“Mendoj se për çdo njeri është shumë e rëndësishme të gjykojë problemin për religjionin e vet”, më tha zonja Kirsilova shumë serioze.

“Mendoj se për mua është shumë më e këndshme të vëzhgoj njerëzit dhe përpos të tjerave lidhjen e tyre para religjionit, cilido qoftë besojnë”, iu përgjigja asaj.

“Por secili duhet të jetë i interesuar për ekzistencën e Zotit?!”

“Askujt nuk i duhet të merret me faktin nëse tjetri është fetar apo jo dhe sinqerisht kjo është diçka tejet budallaqe që dikush të interesohet për të, duhet të shikojë punën e vet”, ishte shumë për mua kjo bisedë dhe duhet të përfundoja diku.

Atëherë të dy e mbyllëm, ajo e kuptoi dhe përtypi ushqimin, unë piva shishen time të verës dhe dola jashtë.

Pas drekës vendosa që për herë të parë të ngjitesha në majë të kodrës. Kodra quhej Tragjedia. Nuk e dija përse. Nuk pyeta deri më atëherë as edhe një. Të gjitha ishin të panjohura për mua, por në fakt kisha dhe dëshirën që disa nga këto gjëra, të mbeteshin kështu, të panjohura, të paktën si fillim.

Fillimisht, ika në banesë, mora një hartë të vogël që e kisha gjetur në bibliotekë dhe çantën e shpinës në të cilën vendosa trikon dhe atëherë, ia arrita të ngjitem në majë të saj përmes shtigjeve të ngushta dhe të pjerrëta mes pyllit. Atje frynte një erë e ftohtë dhe e fortë, që vinte nga Zvicra, përmes liqenit. Qëndrova këtu njëfarë kohe, ishte bukur të shikoje drejt majës të maleve dhe në liqenin e madh poshtë tij. Në largësi shikoheshin dhe ato majat me borë, ishin në distancë, shumë më të lartë, por megjithatë ishte bukur t'i këqyrje. Ishte ftohtë dhe ndaj veshja trikon. Qëndrova gjatë. Ishte e çuditshme, kodra s'ishte shumë e lartë por në të vërtetë ishte mjaft më ftohtë se poshtë në rrëzë në kopshtin e vilës. Ishte kjo për shkak të asaj ere nëntori ardhur nga bjeshkët e Alpeve.

Më pas zbrita në një drejtim tjetër, në anën tjetër të kodrës, në shtigje akoma më të pjerrëta dhe më të ngushta dhe mbërrita në bregun e liqenit. Uji ishte tejet i paqmë. Qëndrova në një shkëmb të lagësht ku uji po më stërpikte

ngadalë këpucët. Ishte i pastër dhe i kthjellët dhe ngjante me ujin e detit. Vura dorën në liqen. Ishte akull. Pashë një velierë, me velën të hapur shumë që po lundronte shpejt. Qëndrova në këtë shkëmb dhe i vështrova të gjitha.

Dhe në fund, ishte e mjaft kjo që kërkova për këtë ditë dhe e mjaftueshme ecja. Në të vërtetë u kënaqa mjaft.

U ktheva në dhomë, vetëm sa për t'u plandosur në krevat, këtë doja në atë moment t'i kujtoja të tëra dhe të mendoja për të gjitha, dhe t'i ruaja diku, t'i kisha kurdo që të më duheshin në jetë. Dhe më duheshin të gjitha, të tilla gjëra të duhen gjithnjë, mendova. Kështu, kam pritur darkën.

Para mbrëmjes rashë në ujdi me kamerierin të ma rregullonte për të parë transmetimin e ndeshjes së futbollit *Partizani-Lacio* në sallën e televizionit në katin e dytë të vilës. Dhe rreth tetë e gjysmës kamerieri mu afrua në kohën e ngrënies së darkës, më pëshpëriti në vesh se filloi ndeshja dhe unë papritmas u ngrita nga tryeza, fshiva buzët me pecetë dhe u kërkova ndjesë mysafirëve të tjerë, në një mënyrë të tillë që të dukesh sikur kisha një thirrje të papritur telefonike. Kështu e bëmë me fjalë unë dhe kamerieri. Ishte një tip i mirë, ky kamerieri, që quhej Gregorio. Ishte një ndryshim i madh mes atij dhe mysafirëve. Me të mund të komunikoj lehtë. Më përcolli në katin e dytë në sallën e televizionit, shtriva këmbët në kolltuk dhe ndeza televizorin. Ai profesori i kompozicionit, zoti Menudi Uinter, po mbante një koncert solo në një nga sallat e *Vilës Serboni* tamam në kohën kur filloi ndeshja. Zgjedha megjithatë të vazhdoja të shikoja ndeshjen, zgjedha të rrija në kolltuk me gotën e verës së kuqe në duar. Në pushimin e ndeshjes eca korridoreve, duke parë pikturat e vjetra, skulpturat, vazot dhe shandanët e florinjte. Mermeri poshtë ndriçonte. Dëgjohej muzika e qetë e pianos dhe në pushime duartrokitjet me zhurmë nga salla e koncertit. Nuk tingëllonte aspak keq ajo muzikë. Qëndrova pak në korridor. Dëgjova muzikën. Tonet i përshkonin gjatazi korridoret e mëdha dhe të zbrazëta të vilës së madhe. Nuk ishte askush përveç meje, nuk ishin madje as edhe njerëzit e stafit. Vetëm

muzikë. Nuk ishte aq keq. Dëgjova vetëm pak. U ktheva në sallën e televizorit dhe ngrita tonin, ndërsa në stadium tifozët bërtisnin: "Serbia! Serbia!" Dhe italianët fituan.